

**“INFORMACION MBI KUSHTET DHE LISTA E CMIMEVE PER PRODUKTET E KREDISE KONSUMATORE, NE FUQI PREJ DATES 01.06.2023”**

<b>Qellimi i dokumentit</b>	Ky dokument perben nje prezantim te kushteve dhe cmimeve te kredise konsumatore ne luteCredit
<b>Kontakte:</b>	luteCredit Albania sha Rruga: Andon Zako Cajupi, Ndertesa Nr. 3, Hyrja 2, Tirane +355 44505060 info@iutecredit.al <a href="http://www.iutecredit.al">www.iutecredit.al</a>
<b>Qellimi i Kredise:</b>	Kredite konsumatore ne vlera te vogla synojne te permbushin nevojat personale te individeve per blerje produktesh, apo nevojte te tjera te tyre.
<b>Normat e Interesit</b>	Norma e Interesit - llogaritet si nje perqindje vjetore mbi principalin e papaguar te huase per cdo periudhe dhe te shprehur si norma vjetore e 360 diteve te vitit dhe 30 diteve te muajit.  <b>Kredia Cash</b>  Shuma: 5,000 Leke – 500,000 Leke Norma e interesit: 5-20% Afati: 3-48 muaj  <b>Kredia Partner Cash*</b>  Shuma: 5,000 Leke – 500,000 Leke Norma e interesit: 1-20% Afati: 6-48 muaj  <i>*Kredi promovionale e vlefshme deri me date 30.06.2023</i>  <b>Kredia Dealer</b> – Kredi per blerje produktesh ne pika te autorizuar Shuma: 5,000 Leke – 400,000 Leke Norma e interest: 0-15% Afati deri: 48 muaj
<b>Norma Efektive e interesit (NEI)</b>	Norma efektive e interesit NEI eshte totali i kosos se kredise per klientin e shprehur si perqindje vjetore e vleres se kredise se dhene. Kostoja totale e kredise per klientin eshte totali i te gjitha shpenzimeve ku perfshihen interesat, komisionet dhe cdo lloj tjetër shpenzimi qe klienti paguan per kredine sipas kushteve te marreveshjes se kredise (shpenzimet per sherbimet ndihmese per marreveshjen e kredise, ne vecanti primet e sigurimit, perfshihen nese sherbimi eshte i detyrueshem per te perfituar kredine ose normen e interesit te aplikuar)
<b>Komisioni i Angazhimit</b>	Komisioni i Angazhimit llogaritet mbi shumën e kredisë dhe duhet të paguhet plotësisht në ditën e nënshkrimit të Kontratës së Kredisë Specifike dhe do të zbritet nga shuma e kredisë. Nëse Klienti ka paguar një komision angazhimi dhe po ushtron të drejtën e tij për t'u tërhequr nga Kredia, Klienti do ta kthejë Kredisë duke perjashtuar Komisionin e Angazhimit. <b>Kredia Cash</b> Komisioni: 3% <b>Kredia Partner Cash</b> Komisioni: 1-3%
<b>Komisioni i Procesimit</b>	Komisioni i Procesimit llogaritet mbi shumën e kredisë dhe duhet të paguhet në ditën e nënshkrimit të Kontratës së Kredisë Specifike, megjithatë, palët bien dakord që Komisioni i Procesimit të paguhet së bashku me detyrimet mujore të kredisë, i ndarë në pjesë të barabarta sipas Grafikut të Pagesës, shtojcë e Kontratës së Kredisë Specifike. Për të shmangur dyshimet, tarifa e komisionit te procesimit paguhet plotësisht edhe në rast të një

	<p>shlyerjeje të parakohshme të kredisë ose përfundimit të parakohshëm të Kontratës për çfarëdo arsye.</p> <p><b>Kredia Cash</b> Komisioni total: 1%-35%</p> <p><b>Kredia Partner Cash</b> Komisioni total: 1.7%-71.9%</p> <p><b>Kredia Dealer</b> – Kredi për blerje produktesh në pika të autorizuara Komisioni total: 0% -52%</p>
<b>Komisioni i Administrimit</b>	<p>Komisioni i Administrimit llogaritet si përqindje mbi shumën e disbursuar. Ky komision shpërndahet në të gjithë kështet mujore të kredisë dhe falet në rastin e shlyerjes së hershme të kredisë.</p> <p>Per produkte dhe partnere të ndryshëm ofrohen komisionet e mëposhtme të administrimit:</p> <p><b>Kredia Dealer</b> – Kredi për blerje produktesh në pika të autorizuara Komisioni i administrimit: 0 -4% në muaj mbi shumën totale të disbursuar</p> <p><b>Kredia Cash &amp; Kredia Partner Cash</b> Komisioni mujor: 0%-1.9%</p>
<b>Komisioni i tërheqjes në ATM</b>	<p>Në rast se Huamarrësi do të zgjedhë, me vullnetin e tij, të tërheqë huanë në një prej ATM-ve të vendosura në dispozicion për këtë qëllim nga Huadhënësi, komisioni i tërheqjes në ATM, do t'i shtohet principalit të huasë dhe mbi të do të llogaritet interesi dhe komisionet sipas kësaj Kontrate. Komisioni i tërheqjes në ATM është 2.5% për çdo shumë që tërhiqet në ATM. Komisioni i tërheqjes në ATM do të paguhet nga Huamarrësi vetëm në rast se ky i fundit zgjedh të tërheqë huanë pranë ATM-ve të vendosura në dispozicion nga Huadhënësi.</p>
<b>Komisioni i Shtyrjes së datës së pageses</b>	<p>Komisioni i Shtyrjes së datës së pageses është komisioni që paguhet nga huamarrësi në rast pezullimi të detyrimeve të Huamarrësit me kërkesë të këtij të fundit për disa ditë pa ndryshuar datën e pageses në grafikun e pagesave. Komisioni është <b>1,000 leke</b> për çdo shtyrje. Për çdo ditë shtyrje nuk aplikohet penaliteti ditor për ditëvonesë por në rast se klienti nuk paguan brenda afatit të shtyrjes atëherë në përfundim të këtij afati i aplikohet penaliteti ditor të vonesës për të gjitha ditët e shtyrjes.</p>
<b>Levrimi i Kredisë</b>	<p>Levrimi i kredisë së klientit do të kryerhet në monedhën LEK në një nga pikat e autorizuara partnere të luteCredit. Këta partnerë janë: POSTA SHQIPTARE, Agjensite UNION NET WESTERN UNION, EASYPAY, RAEAFS, ATM ose në llogarinë bankare të deklaruar nga Klienti.</p>
<b>Shlyerja e Kredisë</b>	<p>Shlyerja e kredisë nga Klienti do të kryhet në përputhje me planin e pageses që klienti do të dakortesoje në momentin e nënshkrimit të kontratës së Kredisë.</p>
<b>Tabela e llogaritjes së NEI</b>	<p>Në rast se shuma e kredisë është 100,000 leke dhe afati i saj është 6 muaj atëherë koston mujor është 19,466 leke (i rrumbullakosur me përjashtim të koston të fundit). Shuma totale që klienti paguan në fund është 117,576 leke bashkë me interesat të cilat janë 7,267 leke, me komisionin e procesimit të cili është 10,309 leke ndërkohë që komisioni i angazhimit të cili paguhet në fillim është 3,000 leke.</p> <p>Ekuacioni shndërrohet si në vijim: <math>100,000 = 117,576 / (1+i)^{(6/12)} = 117,576 / (1+i)^{0.5}</math>;</p> <p><math>(1+i)^{0.5} = 117,576 / 100,000</math></p> <p><u>NEI = 97.23%</u></p> <p>i (NEI) – është norma efektive e interesit, e cila mund të llogaritet (nga algjebra ose nga një program kompjuteri) si më poshtë:</p> <p>M -tk m' -ti</p>

	$\sum_{K=1} Kk (1+i) = \sum_{l=1} RI (1+i)$ <p>m - është numri total i kësteve të lëvrimit të kredisë, nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste (drawdowns), të paguar nga kredidhënësi.</p> <p>k - është kësti i k-të i kredisë i lëvruar nga kredidhënësi (nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste), kështu që <math>1 \leq k \leq m</math>. Kk - është vlera e këstit të kredisë (drawdown) të vënë në dispozicion të klientit (të lëvruar) në periudhën k.</p> <p>tk - është intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së lëvrimit të këstit të parë të kredisë (first drawdown) të vënë në dispozicion të klientit (nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste) dhe datës së çdo kësti pasues të kredisë të vënë në dispozicion të klientit, domethënë <math>t_1 = 0</math>. m' - është numri total i kësteve të paguara nga klienti për shlyerjen e kredisë dhe/ose pagesave të shpenzimeve.</p> <p>l - është pagesa e l-të e kryer nga klienti për shlyerjen e kredisë ose pagesën e shpenzimeve.</p> <p>RI - është vlera e këstit të shlyerjes ose pagesës së shpenzimeve nga klienti në periudhën l</p>								
<b>Komisioni i njoftimit të Vonese</b>	<b>Komision i Njoftimit të Vonese</b> ne kete kontrate dhe kontratat specifike qe do te lidhen ne kuader te saj ka kete kuptim: eshte kuote qe paguhet nga Kredimarrsi per te mbuluar shpenzimet administrative qe ben Kredidhenesi per te njoftuar kredimarrsin per pagesen e tij ne vonese me ane te mjeteve te qendrueshme te komunikimit te tilla si Leter njoftuese (shpenzime administrative per pergatitjen dhe dergimin e letres si dhe njoftimet e tjera me ane te telefonatave) dhe sms (shpenzime administrative per pergatitjen dhe dergimin e sms). Ky komision parashikohet ne cdo kontrate specifike								
<b>Kamat vonesa ditore dhe Penaliteti ne daten e mbylljes se kontrates</b>	Huamarrësi është i detyruar t'i paguajë Huadhënësit Kamatëvonesën në rastin e pagesave të kësteve që kryhen pasi ju ka kaluar afati (pagesa në vonese) në shlyerjen e detyrimeve. Kamatëvonesa do të jetë 1.5 % (një pike pese për qind) në ditë e llogaritur mbi shumën e principalit plus interesin e çdo kësti në vonese duke nisur nga e nesërmeja e datës kur detyrimi është bërë i kërkueshëm. Kamatëvonesat e parashikuara të cilat paguhet nga kredimarrsi, nuk tejkalojnë në asnjë rast më shumë se 30% të shumës së Principalit plus interesit të këstit në vonese. Zbatimi i Kamatëvonesës nuk cenon të drejtën e Huadhënësit për të nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm apo për të zgjidhur Kontratën në përputhje me parashikimet e saj. <p>Penaliteti në daten e mbylljes së kontrates është 30% të Principalit e të gjitha kësteve të ardhshme duke nisur nga data e mbylljes së kontrates.</p>								
<b>E drejta e tërheqjes nga kredia konsumatore</b>	Klienti ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata e kredise per nje periudhe 14 ditore nga data e nënshkrimit të kontrates. Në rast se Klienti ushtron të drejtën e tij për t'u tërhequr nga Kontrata e Kredisë Specifike, ai do t'i kthejë Kredidhënësit shumën e kredisë dhe do të paguajë interesin e përlllogaritur për periudhën nga data e nënshkrimit të Kontratës së Kredisë Specifike deri në datën e shlyerjes së shumës së kredisë dhe interesit të përlllogaritur, pa vonesa të panevojshme dhe jo më vonë se brenda periudhës 14-ditore të tërheqjes. Interesi llogaritet në bazë të normës së interesit në ditë siç është rënë dakord në Kontratën e Kredisë Specifike.								
<b>Shlyerje perpara perfundimit te afatit te kredise</b>	Nese klienti e mbyll kredine perpara kohe, falet 100 % i interesit dhe komisionit te administrimit te mbetur per muajt pasardhes nderkohe qe komisioni i procesimit do te shlyhet sipas kushteve te rena dakort. <p>Ne rast te shlyerjes perpara perfundimit te afatit te kredise komisioni i shlyerjes perpara kohe eshte 0 leke.</p>								
	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="355 2000 523 2121">Nr</th> <th data-bbox="523 2000 675 2121">Datat e pageses</th> <th data-bbox="675 2000 786 2121">Principal</th> <th data-bbox="786 2000 898 2121">Interes t</th> <th data-bbox="898 2000 1010 2121">Komision i i Procesimit</th> <th data-bbox="1010 2000 1161 2121">Komisioni i administrimit</th> <th data-bbox="1161 2000 1361 2121">Principal dhe Interes i papaguar</th> <th data-bbox="1361 2000 1500 2121">Penalitet 30 %</th> </tr> </thead> </table>	Nr	Datat e pageses	Principal	Interes t	Komision i i Procesimit	Komisioni i administrimit	Principal dhe Interes i papaguar	Penalitet 30 %
Nr	Datat e pageses	Principal	Interes t	Komision i i Procesimit	Komisioni i administrimit	Principal dhe Interes i papaguar	Penalitet 30 %		

Shembull per llogaritjen e kamat vonesave ditore dhe penalitetit ne ditën e mbylljes se kontrates	1	20.06.2021	3,859	699	1,042	600	4,558	1,367.4
	2	20.07.2021	3,913	645	1,042	600	4,558	1,367.4
							<b>Principali i kesteve te ardhshme nga data e terminimit</b>	<b>Penalitet 30 %</b>
	<b>Data e Mbylljes se Kontrates</b>	20.08.2021	3,948	610	1,042	600	42,228	12,668.4
	4	20.09.2021	4,005	553	1,042	600	0	
	5	20.10.2021	4,079	479	1,042	600	0	
	6	20.11.2021	4,122	436	1,042	600	0	
	7	20.12.2021	4,194	364	1,042	600	0	
	8	20.01.2022	4,242	316	1,042	600	0	
	9	20.02.2022	4,304	254	1,042	600	0	
	10	20.03.2022	4,384	174	1,042	600	0	
	11	20.04.2022	4,429	129	1,042	600	0	
	12	20.05.2022	4,521	60	1,038	600	0	
<b>Total</b>		<b>50,000</b>	<b>4,719</b>	<b>12,500</b>	<b>7,200</b>	<b>0</b>	<b>15'403.2</b>	
Totali i Penalitetit						154,03.2		
<p>Shuma e kredise eshte 50,000 leke. Afati i kredise eshte 12 muaj. Kesti i Kredise eshte 6,200 leke. Principali dhe interesi per cdo kest eshte 4,558 leke. Në rast mos-pagimi të detyrimit mujor luteCredit aplikon një penalitet ditor prej 1.5 % të Principal dhe Interes ( Ne rastin tone aplikohet mbi 4,558 leke). Në rast vonese klientit i mbyllet kontrata ne ditën e 50-te te vonesës. Ne rast mospagese do te kemi situatën e meposhtme:</p> <p>1- Penaliteti per kestin e pare ne vonese eshte 1,367.4 leke (1.5% * 4558 leke* 20 dite vonese).</p> <p>2- Penaliteti per kestin e dyte ne vonese eshte 1,367.4 leke (1.5% * 4558 leke* 20 dite vonese).</p> <p>3- Penaliteti ne datën e mbylljes se kontrates eshte 30% te Principalit e te gjitha kesteve te ardhshme duke nisur nga data e mbylljes se kontrates. Principali i 10 kesteve te ardhshme nga data e mbylljes se kontrates eshte 42,228 leke * 30 % =12,668 leke.</p> <p>4- Totali i penaliteteve eshte 15,403 leke.</p> <p>• <i>Shëmbulli i mësipërm është indikativ dhe ndryshon në varësi të shumës së disbursuar, ditën në të cilën terminon kontrata, kështu mujor të kredisë apo nëse kësti mujor paguhet i plotë apo i pjesshëm nga klienti. *Penaliteti stopon kur shkon 30 % te Principalit dhe Interesit ne vonese. Theksojme se klienti duhet të paguajë të gjithë detyrimin bashkë me penalitetet e shtuara për shkak vonese , sepse nëse nuk e paguan të plotë do të vazhdojnë të akumulohen penalitete mbi pjesën e papaguar të principalit dhe Interesit ; Edhe në këtë rast, te një pagese te pjesshme *Penaliteti ditor vijon te llogaritet dhe stopon kur shkon 30 % te pjeses se mbetur te papaguar te Principalit dhe Interesit .</i></p> <p>Kjo skeme penaliteti implementohet per keestet ne vonese duke filluar nga <b>01 Janar 2022</b></p>								
<b>Komisione per leshim vertetimesh / dokumentacioni</b>	<p>Vërtetim mbyllje kredie 1,000 Lek;  Vërtetim balance kredie 2,000 Lek;  Kopje e Kontratës së Kredise 1,000 Lek;  Kopje e planit të pagesave (installment table) 1,000 Lek;  Ndryshim i kolateralit për Kreditë e Makinave 2,000 Lek;  Bllokim i kolateralit (mjet motorrik) në RBS – 1,600 Lek;  Zhbllokim i kolateralit në RBS – 2,000 Lek;</p>							